



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Rektoratin e Universitetit “Aleksander Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, specialist i buletinit,

Specialisti i buletinit, është përgjegjës për:

- Është nëpunës i nivelit ekzekutiv; Është nëpunës i nivelit ekzekutiv; *Specialisti i Buletinit Shkencor*: është përgjegjës për organizimin, koordinimin, mbledhjen dhe redaktimin e materialeve për Buletinin Shkencor të Universitetit të Elbasanit. Mban komunikimin me Bordin Editorial dhe Redaksinë e Buletinit Shkencor duke bërë dhe njoftimet përkatëse. Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit dhe redaksisë së Buletinit. Formulon, analizon dhe redakton informacione për botim/publikim në bashkëpunim me sektorët e tjerë të institucionit. Raporton tek eprorët në lidhje me veprimtarinë e punës së kryer.

### **Kriteret e përgjithshme:**

- të zotërojë diplomë të ciklit (nivelit) të dytë të studimeve Master, në fushën e shkencave humane/komunikimit. (Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga ministria e linjës).
- të ketë përvojë pune.
- të ketë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuar me dokumentacion.
- të mos jetë dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- të jetë i aftë për punë.

### **Kriteret e veçanta:**

- Të ketë mbi 3 (tri) vite përvojë të mëparshme në fushën e komunikimit
- Të ketë njohuri dhe kualifikime profesionale në fushën e kërkuar
- Njohës i mirë i përdorimit programeve kompjuterike.
- Referenca pune nga punëdhënësi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**23.03.2022 - 01.04.2022**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

- Letër motivimi për pozicionin e punës specialist i buletinit në Drejtorinë e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (23.03.2022 - 01.04.2022) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist i buletinit*  
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (05.04.2022 – 20.04.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.